



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2021:226767

Datë: 13.03.2025

Numri i dokumentit: 06987913

C.nr.1577/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.P. nga Mitrovica, të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Sheremet Ademi dhe Leutrim Ademi, avokat me seli në Mitrovicë, kundër të paditurit SPR – “Dr. S.H” në Mitrovicë, me objekt kontesti “kompenzimin e pagave të 13-ta (trembëdhjeta)”, me vlerë të kontestit 935.00 euro, jashtë seance, me datë 13.03.2025 nxjerr këtë:

AKTGJYKIM

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses A.P. nga Mitrovica me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET i padituri SPR – “Dr. S.H” në Mitrovicë që në emër të kompenzimit të pagës jubilarë për 20 (*njëzet*) vite përvoje pune dhe atë për periudhën e vitit 01.10.1999 deri më 01.10.2019, ashtu që për secilin vit në vlerë prej 467.00 euro, e që në total të i paguhet paditësit shuma në vlerë prej 935.06 euro, me kamatë ligjore prej 8% e cila do të llogaritet që nga dita e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive në afat prej 7 (shtatë) ditësh nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- II. DETYROHET i padituri SPR – “Dr. S.H” në Mitrovicë, që paditëses, t’ia kompenzojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124 (*njëqind e njëzet e katër*) euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi me datën 11.10.2021, ka ushtruar padi për kompenzimin e pagave jubilarë për periudhën kohore duke filluar prej vitit 01.10.1999 e deri më 01.10.2019, ashtu që për secilin 10 vjeçar

përvoje pune ka kërkuar vlerën prej 467.00 (*katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë*) euro, e që në total të i paguhet paditësit shuma në vlerë prej 935.06 (*nëntëqind e tridhjetë e pesë euro e gjashtë cent*) euro dhe atë me kamatë ligjore prej 8% prej momentit të parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, kjo duke u bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, fillimisht vërejtë se padia është përpiluar në tërësi në përputhje me dispozitën nga neni 253, lidhur me nenin 99 të LPK-së, pas plotësimit të kushteve ligjore të njëjtën (së bashku me dokumentet e bashkëngjitura në të), me Aktvendimin që mban shenjë C.nr.1577/2021 të datës 04.12.2023 detyron të paditurën që në afat prej 15 ditësh të paraqesë përgjigjen në padi nën kërcënimin e pasojave juridike. Tutje e paditura me parashtrësën e datës 28.12.2023 (përgjigjen në padi) e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Paditësi në padi thekson se është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga viti 1999 si dhe i njëjti akoma vazhdon në ushtrimin e profesionit të tij në të njëjtin vend pune. Në shkresat e lëndës është bashkëngjitur edhe kërkesa e paditësit, e datës 07.09.2021 drejtuar të paditurës, kërkesë kjo për kompenzimin e pagave jubilarë, më pas Vërtetimin me nr.Prot. 333 të datës 05.02.2020, Kontratën e Punës me nr.prot.1511 të datës 03.03.2014 si dhe listen e pagës të datës 31.08.2021 me të cilën vërtetohet se paditësi realizon të ardhura nga marrëdhënia e punës.

E paditura e pohon faktin se paditësi është i punësuar tek e paditura, por e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke u thirrur në pavlefshmërinë e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë lidhur me kërkesat e pagës së 13-të të punëtorëve të shëndetësisë, andaj e paditura e vë në pah faktin se kërkesëpadia e paditësit është e pasafatshme.

Duke marrë parasysh faktin se pretendimet petitore paditësi i ka bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, për të cilën Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerr mendim juridik të datës 9 Tetor të vitit 2023 në lidhje me këtë kontratë, e cila në nenin 17 paragrafi 2 parasheh që *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*, gjithashtu paragrafi 3.2 i po këtij neni parasheh që *“Punëtorët shëndetësor në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore në vlerë të dy pagave të tij”* andaj, gjykata vlerësoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Me rastin e përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkëngjitura, kjo gjykatë erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi del themelësia e kërkesëpadisë, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritator pa caktuar seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës nga neni 398 par.1 të LPK-së, e cila shprehimisht parasheh se: *“Kur gjykata pasi t’i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera në dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo pa caktuar fare seancë gjyqësore mund të jep aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Si dhe gjykata pas vlerësimit të gjendjes lidhur me parashkrimin e kërkesës për kompenzimin e pagës jubilarë, ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar kompenzimin e pagës së 13-të (*trembëdhjetë*) dhe atë për vitin 1999 deri në vitin 2019, nuk është e përfshirë në parashkrim, duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit Nr.03/L212 të Punës, i cili ka përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e po ashtu pati parasysh edhe nenin 342 par.1 të LMD-së sipas të cilit *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Padia e paditësit e ushtruar kundër të paditurit është bërë me datë 11.10.2021, ndërsa e drejta e paditësit për të kërkuar pagat jubilarë, ka rrjedhë nga fillimi i vitit 1999 e deri më vitin 2019 dhe si e tillë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e aprovuar si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit.

Lidhur më kumatën ligjore të kërkuar nga paditësi, duke qenë se e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata ka vendosur që kumatë vonesa të jetë prej 8 për qind, duke u bazuar në nenin bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit padisë në gjykatë (24.06.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kumatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur nga paraqitja e padisë është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së ashtu që ashtu që detyrohet e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve

gjqësore t'ia paguaj shumën prej 124.00 € dhe atë 104.00 € për përpilimin e padisë, si dhe 20.00 € në emër të taksës gjyqësore për padi, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga të lartëcekurat, e duke u bazuar në nenin 398 të LPK-së, nenin 342.1 të LMD-së dhe nenin 87 e Ligjit të Punës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil  
C.nr.1577/2021 datë 13.03.2025

GJYQTARI  
Skender Shala

*UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:*

*Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese ne afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimiit te këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.*